

MANIFESTIM MADHËSHTOR NË BAZEL ME PRANI EDHE TË ARTISTES TONË TË MADHE VAÇE ZELA

Me rastin e festës së flamurit në një nga sallat më të bukura të hotelit Mittenza në MuttENZ, ku morën pjesë rreth 1300 shqiptar, në mes të tyre edhe miq zvicëranë, të prirë nga dëshira për të njohur e përjetuar kulturën dhe festimet tona, patën rastin që në një atmosferë të ngrohtë festive, të kalojnë ca çaste me artistët tanë nga viset e ndryshme shqiptare, por edhe nga diaspora. - Në këtë manifestim merrnin pjesë edhe anëtarë të personelit të ambasadave shqiptare në Zvicër në krye me Ambasadorin e Shqipërisë në Bernë z. Mehmet Elezi, i shoqëruar edhe nga ambasadori i Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në Gjenevë z. Sejdi Qerimaj

Tash sa vite Këshillimorja për Kualifikimin e Emigrantëve dhe Emigranteve në Basel, (më parë ish-këshillimorja shqiptare) është padyshim njëra ndër këshillimoret më të organizuara në Zvicër, që i ka kushtuar rëndësi të vazhdueshme afirmimit të kulturës shqiptare si dhe afrimit të komunitetit tonë me popullin mik zvicëran, por edhe me pjesëtarët e komuniteteve të tjera që jetojnë në këtë mjedis shumë kulturorë e shumetnik. Ajo nuk dallon për nga aktiviteti vetëm me këshilla e kurse dedikuar mërgimtarëve tanë por edhe me një sërë organizimesh kulturore e sportive, duke qenë edhe organizatore edhe sponsorë e tyre njëkohësisht. Të gjithë ata që kanë pasur rastin t'i shohin e ndiejnë më për së afërmi këto organizime apo manifestime, kanë pasur rastin të ndjejnë frymën e një afrie sa njerëzore aq edhe kulturore.

Po kjo frymë u bartë edhe sivjet me rastin e kremtimit Ditës së Flamurit - më 28 Nëntor, ku si edhe në shumë vende të botës mërgata jonë u mblodh të festojë së bashku. Në këtë manifestim, i cili u mbajt në një nga sallat më të bukura të hotelit Mittenza në MuttENZ morën pjesë rreth 1300 shqiptarë të vjetër e të rinj nga Baseli dhe vende të tjera, në mes të tyre kishte edhe miq zvicëranë, të cilët nuk



Këngëtari ynë i mirënjohur, Ilir Shaqiri përshëndet ngrohtësisht këngëtarën tonë të famshme me banim në Bazel, z. Vaçe Zela



Manifestimi u hap me Himnin Kombëtar interpretuar me mjeshtëri të rrallë nga Ilir Shaqiri dhe i përcjell nga grupi i fëmijëve

Bashkuara në Gjenevë z. Sejdi Qerimaj, me bashkëshortet.

Por edhe artistët e ftuar Ilir Shaqiri, grupi i valltarëve të Shkollës Shqiptare në Zvicër "Shota", Violeta Kajtazi, Zana Paloja, Adelina Rama, Albert Dani si dhe shkolla shqipe nga Aesch i falën kësaj mbrëmje zërin dhe interpretimet e tyre tejet kreative. Ata jo vetëm që kënduan, recituan dhe vallëzuan me muzikë të të gjitha trevave shqiptare, por edhe përmes kontakteve të tyre i thelluan edhe më tej urat e miqësisë e bashkëpunimit. Ishte te-

kuar për integrim në BS dhe BL zt. Tomas Kessler dhe zj. Julia Moreis, e qe mbetën pa fjale nga ajo që përjetuan. Në këtë manifestim përpos medieve shqiptare ishin dhe ato vendore zvicërane.

-Kjo nuk është hera e parë që ABSM (Ausbildungs- und Beratungsstelle für Migrantinnen und Migranten) organizon manifestime të tilla festive, por e veçanta e këtij organizimi ishte përfshirja në organizim edhe e Integrati-

onstella BL si dhe e të gjitha subjekteve politike, sportive e fetare shqiptare, gjë që na bashkoi dhe na gjë që kjo na dha mundësinë të ndihemi shqiptar midis shqiptarëve në një ditë të madhe si kjo e 28 Nëntorit, thonë drejtuesit e kësaj këshillimore që zhvillon një aktivitet të shumanshëm, nga i cili dallon ai kushtuar edhe afirmimit të kulturës shqiptarëve dhe integritet të pjesëtarëve të komunitetit tonë në shoqërinë zvicërane. /Rexhep Rifati



Në mesin e mysafirëve edhe Ambasadori shqiptar, z. Mehmet Elezi, këngëtarja e famshme Vaçe Zela dhe të ngarkuar për integrim në BS dhe BL zt. Tomas Kessler dhe zj. Julia Moreis

morën pjesë vetëm nga kureshtja, por thjeshtë nga dëshira për të njohur e përjetuar kulturën dhe festimet tona.

Kësaj radhe, për kënaqësinë e të gjithëve në këtë mbrëmje ishin të ftuar dhe nderuan manifestimin e me pjesëmarrjen e tyre: E madhja Vaçe Zela, ambasadori i Shqipërisë në Bern, z. Mehmet Elezi, i shoqëruar edhe nga ambasadori i Shqipërisë pranë Kombeve të

jet mbresëlënës momenti ku artisti i shquar Ilir Shaqiri iu afrua këngëtares sonë të famshme, Vaçe Zela dhe u përkul para saj me respekt dhe dashuri të veçantë.

Përndryshe, manifestimi u hap me himnin kombëtar interpretuar me mjeshtëri të rrallë nga Ilir Shaqiri dhe i përcjell nga grupi i fëmijëve. Në festimin e 28 Nëntorit ishin të pranishëm edhe përfaqësues kantonale të ngar-



Valltarët e Shkollës Shqiptare të vallëzimit "Shota" në Zvicër

munishi schreinerei



ÇMIME TË VOLITSHME

KUZHINA TË KUALITETIT MË TË LARTË ZVICERAN

VITRINA, ENTERIER, RENOVIME DHE MONTIM

Përfaqësues i firmës zvicërane

BP Piatti

Adresa: Letzistrasse 29, CH -9015 St. Gallen
 Tel. 076 428 66 00 dhe 076 319 38 09
 Fax. 071 920 09 38
 info@munishi.ch, www. munishi.ch